



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent / Agencija za upravljanje vanrednim situacijama Kosova /Emergency Management Agency

Agjencia e Menaxhimit Emergjent

shpall

K O N K U R S

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik
2026/2027**

Agjencia e Menaxhimit Emergjent, për vitin akademik 2026/2027, do të regjistrojë **8 (tetë)** studentë në vitin e parë të studimeve në programin studimor bachelor 'Siguri Publike' në Fakultetin e Sigurisë Publike të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), sipas kuotës së përcaktuar nga Bordi i AKSP-së.

KUSHTET E KONKURSIT

Kushtet e përgjithshme për aplikim në studimet bachelor për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike janë si në vijim:

1. Të kenë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të vërtetuar me diplomë;
2. Të jenë të punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Formulari i aplikimit i plotësuar dorëzohet së bashku me dokumentet në kopje fizike si vijon :

- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e kartelës identifikuese të punës;
- Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të shkollës së mesme dhe diploma origjinale e shkollës së mesme ose kopjet e noterizuara, nëse shkollimi i mesëm është kryer jashtë vendit duhet edhe vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

Për zyrtarët që përzgjedhin nga Institucionet e Sigurisë Publike për regjistrim në studimet bachelor lidhet Kontrata mes Institucionit punëdhënës dhe zyrtarit të përzgjedhur në mënyrë që pas përfundimit të studimeve bachelor zyrtari të shërbejë në institucionin punëdhënës, sipas vendimit të përcaktuar nga Bordi i AKSP-së (rikthimi i investimeve).

Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme, në Prishtinë, Hajvali.

Studimet bachelor për pjesëtarët e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent ofrohen falas dhe pa shkëputje nga puna.

AFATET E KONKURSIT

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 03.08.2026 deri më 17.08.2026, në ora 16:00.

MËNYRA E TESTIMIT:

Testi me shkrim do të mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të AME, në Prishtinë, Hajvali, 24.08.2026 nga ora 10:00.

Kandidatët të cilët i nënshtrohen testit me shkrim duhet të kenë me vete një dokument të identifikimit dhe nuk lejohet asnjë pajisje tjetër elektronike.

SHPLLJA E REZULTATEVE:

Shpallja e rezultateve të testimit do të bëhet brenda dy ditë pune në faqen e AME dhe e-mail-at e kandidateve si njoftim.

ANKESAT:

Kandidatët të cilët nuk pranohen në vitin e parë të studimeve mund të paraqesin ankesë pranë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, pas shpalljes së rezultateve të cilat shqyrtohen brenda dy (2) ditë pune.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni: 038-200 197 dhe e-mail: ame@rks-gov.net